



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 08.11.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit { ... }, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatores znj. Yllka Rupa.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:42 dhe mbaroi në orën 15:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

***Shënim 1:*** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***, si dhe anëtares e Këshillit të Lartë Gjyqësor ***znj. Irena Plaku dhe znj.***

*Marçela Shehu.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI).*
- 6. Sarmela Titka, përfaqësuese Ambasada Amerikane.*
- 7. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.*
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i përgatitur nga relatore znj. Yllka Rupa.

*Ilir Rusi:* Përshëndetje të nderuar kolegë!

Sipas njoftimit dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme datë 08.11.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ju bëj me dije që kjo mbledhje do të drejtohet nga ana ime, Ilir Rusi, si Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, për shkak se Kryetarja zonja Llagami është e angazhuar në një takim institucional. Gjithashtu ju bëj me dije se zonja Shehu nuk do jetë në këtë mbledhje për shkaqe objektive. Ndërsa zonja Plaku nuk është në mbledhje për shkaqe shëndetësore familjare të pjesëtarëve të familjes. Për shkak edhe të numrit të të pranishëm në sallë, mbledhjen e deklaroj të hapur sikundër e theksova.

Duke pasur parasysh faktin se zonja Plaku si relatore e pikës 3 të këtij rendi dite nuk është prezent, atëherë do parashtroja që pika 3 të shtyhet për t’u diskutuar në një mbledhje të ardhshme kur të jetë prezent relatorja.

Ka diskutime?

Jeni dakord me këtë?

Atëherë, pika 3 e rendit të ditës së sotme që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021”, do të shtyhet për t’u relatuar dhe diskutuar në një mbledhje të ardhshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas rendit të ditës, po fillojmë me pikën 1, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, për të cilin është përgatitur relacioni nga relatores znj. Rupa. Për më tej fjalën zonjës Rupa.

Njëkohësisht bëj me dije që zoti {...} ka shprehur edhe kundërshtimet.

***Yllka Rupa:*** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar kolegë!

Në cilësinë e relatores do të prezantoj projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtarin {...}, projektraport i cili ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit) të gjyqtarit që ka kaluar procesin e vlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Në projektraportin e vlerësimit është e pasqyruar në mënyrë të plotë procedura e ndjekur lidhur me këtë proces vlerësimi gjithashtu edhe burimet e vlerësimit. Rezultatet lidhur me burimet e vlerësimit janë komunikuar gjyqtarit i cili ka parashtruar edhe kundërshtimet lidhur me nivelin e vlerësimit dhe të pikëzimit lidhur me dy tregues, përkatësisht rendimentin dhe kontributin në veprimtarinë ndërinstitucionale. Unë do të ndalem në një përmbledhje të analizës së të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit lidhur me nivelin e pikëzimit dhe vlerësimit për të katër kriteret e vlerësimit etik dhe profesional për këtë gjyqtar.

Duke filluar me aftësitë profesionale të gjyqtarit. Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurisë ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale të gjyqtarit

pikëzohen sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilat ndahen në disa nëntregues.

Në lidhje me “Njohuritë ligjore”, përkatësisht “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes si dhe identifikimin e normave konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve. Në këto kushte në lidhje me treguesin aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes ligjin e zbatueshëm dhe konfliktin e normave propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi maksimal me 25 pikë.

Për të kaluar tek “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjeve”, referuar të dhënave nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të gjykatës së Lartë si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Për këto arsye, lidhur me këtë nëntregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Për sa i takon komponentit tjetër “Arsyetimi ligjor” lidhur me “Qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e vendimit” evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme duke u bërë të kuptueshme dhe për një lexues të arsyeshëm dhe jo vetëm për njohësit e mirë të ligjit. Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në procesin civil dhe penal nuk rezulton përdorimi i termave latin por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe. Duke qenë se rezultojnë aftësi të larta të gjyqtarit lidhur me këtë komponent pra “Qartësinë, koncizitetin dhe kuptueshmërinë e vendimit” propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 15 pikë.

Për të kaluar tek “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit gjyqësor”, gjyqtari rezulton se ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të

qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Të gjitha vendimet e analizuara është ndjekur një strukturë të njëjtë duke i bërë ato lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme për lexuesin në lidhje me përmbajtjen kryesisht të tyre. Për këtë arsye lidhur me këtë tregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 10.

Për sa i takon “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, referuar burimeve të vlerësimit kryesisht vendimeve gjyqësore, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i lartë arsyetimi duke u shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin penal si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Gjithashtu edhe në lidhje me këtë nëntregues, propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Në mënyrë të përmbledhur, për sa i takon kriterit të parë “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Në lidhje me “Aftësitë organizative të gjyqtarit” të cilat vlerësohen kryesisht bazuar mbi dy komponentë, “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë” dhe “Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedura gjyqësore”.

Lidhur me të parën sa i takon “Respektimit të afateve ligjore”, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 2 prej tyre parashikohen afate ligjore dhe të dyja rastet gjyqtari ka respektuar afatin ligjor. Pra duke qenë se rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afate shqyrtimi, vlerësoj që në lidhje me këtë nëntregues të vlerësoj gjyqtarin në nivelin maksimal pra të 15 pikëve.

Lidhur me “Plotësimin e standardit minimal kohor”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor

nuk është respektuar vetëm për një çështje. Dhe ky tejkalim kalon vetëm në një çështje nga 13 çështje të analizuara me 18 ditë, duke u konsideruar ky tejkalim i papërfillshëm kam vlerësuar se në lidhje me këtë tregues, gjyqtari të vlerësohet në nivelin e 5 pikëve.

Për sa i takon “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më i shkurtër se standardi minimal kohor, kështu që lidhur me këtë komponent propozohet niveli i vlerësimit me 5 pikë.

Për të kaluar tek “Rendimenti i përfundimit të çështjeve”. Nga analiza e vlerësimit për këtë tregues rezulton se subjekti i rivlerësimit {...}, për periudhën e vlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë. Lidhur me ngarkesën sasiore ai ka deklaruar se për periudhën 2014-2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 438 çështje, ka përfunduar si relator 423 çështje dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 4 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 96.5%. Duke qenë se ka mangësi të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti prej 96.5%, çka përkon me një nivel pikëzimi sipas metodologjisë së vlerësimit, me 8 pikë.

Ndërkohë gjyqtari ka paraqitur kundërshtime lidhur me këtë komponent. Ju jeni njohur me kundërshtimet. Analizon në mënyrë të detajuar të katër çështjet të cilat sipas asaj çka ka parashtruar gjyqtari, nuk do ishte e mundur që të gjykoreshin brenda vitit kalendarik për arsye sepse janë të shortuara në muajt e fundit të vitit. Në lidhje me këto katër çështje është rillogaritur edhe një herë rendimenti duke i përjashtuar nga numri i çështjeve të caktuara dhe edhe në bazë të rillogaritjes rendimenti del 97.4 dhe kjo përqindje sigurisht që nuk afekton, pra nuk e çon në përqindjen e 99%, çka justifikon vlerësimin maksimal prej 10 pikëve të gjyqtarit lidhur me këtë komponent. Gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe standardin që është mbajtur nga Këshilli lidhur me vlerësimin e këtij treguesi për të gjithë gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, vlerësoj që rendimenti i çështjeve të vlerësohet në nivelin e pikëzimit me 8 pikë, pra nuk propozoj ndonjë ndryshim lidhur me pikëzimin e këtij treguesi.

Në lidhje me “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor”, referuar burimeve të vlerësimit koha mestarë e arsyetimit të vendimit përfundimtar klasifikohet më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, kështu që propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë lidhur me këtë tregues.

Për të kaluar tek “Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedura gjyqësore”, sa i takon “Numrit mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, nga tërësia e të dhënave që rezultojn nga burimet e vlerësimi, rezultojn që numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara të jetë 11 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 8 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, rezultojn se gjyqtari ka kryer nga ana tjetër me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural. Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë bërë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë, pavarësisht numrit të lartë të të pandehurve dhe mbrojtësve respektivë, për shkak të natyrës së çështjeve, që ka sjellë si pasojë edhe zhvillimin e një numri të lartë seancash gjyqësore.

Referuar sa më sipër, lidhur me treguesin "numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e tyre”, propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë, pasi provohet shkalla e kujdesit të treguar nga ana e gjyqtarit për shmangien e seancave joproductive dhe administrimin në tërësi të procesit gjyqësor.

Në lidhje me “Kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, referuar të dhënave, rezultojn se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie për këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal në seancat gjyqësore të zhvilluara prej gjyqtarit. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë lidhur me këtë nëntregues, pikët 20.

Në lidhje me “Aftësinë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore” në të dy

komponentët qoftë në aspektin e rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes ku vërehet që renditja e akteve të dosjes e cila është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë lehtësisht të aksesueshme dosjen, për këtë aspekt vlerësohet me 5 pikë, qoftë në aspektin e plotësisë së dokumentacionit të dosjes, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezultojnë se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie edhe për këtë tregues, pra propozohet niveli maksimal i pikëzimit për të dy treguesit që lidhen me dosjen gjyqësore.

Kështu që në lidhje me propozimin për nivelin e vlerësimit mbi kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarit” propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 98.

Për të kaluar tek “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për sa i takon të gjithë komponentëve të këtij kriteri, të gjithë vlerësohen në nivelin maksimal për arsye sepse etika në punë propozohet niveli maksimal prej 35 pikë pasi nga analiza e burimeve të vlerësimit për treguesin angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion për gjyqtarin rezultojnë se përgjatë periudhës së vlerësimit nuk rezultojnë të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore, nuk rezultojnë të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit. Rezultojnë pra se ky gjyqtar reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezultojnë asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij.

Për sa i takon integritetit të gjyqtarit, duke qenë se nga burimet e vlerësimit nuk rezultojnë asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit, propozohet që ky tregues të pikëzohet në nivelin e 40 pikëve.

Për sa i takon paanësisë së gjyqtarit, “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese” rezultojnë se ky gjyqtar në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në komunikimin me subjektet e procedimit ose përbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye propozohet një shkallë shumë e lartë aftësie, niveli i pikëzimit 10.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, gjithashtu është vlerësuar i pakonsiderueshëm, kështu që propozohet niveli i vlerësimit me 15 pikë lidhur me këtë nëntregues.

Kështu që niveli i vlerësimit dhe pikëzimit për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj



vlerave profesionale” propozohet të jetë niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Për të kaluar në kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional i gjyqtarit”. Për sa i takon “Aftësisë së komunikimit”, vihet re një komunikim i qartë dhe transparent. Gjithashtu evidentohet se komunikimi është i saktë, konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e qartë, e kuptueshme, koncize dhe e drejtpërdrejtë, kështu që vlerësohet që gjyqtari në lidhje me këtë tregues ka aftësi të larta, prandaj propozohet niveli i pikëzimit me 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit dhe të dhënat personale dhe për pasojë prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal edhe në lidhje me këtë tregues, prandaj propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

Për sa i takon “Aftësisë për të bashkëpunuar”, në të dy treguesit, si në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta si dhe në aspektin e bashkëpunimit me administratën gjyqësore, vërehet një kujdes shumë i lartë i gjyqtarit, prandaj propozohet përkatësisht vlerësimi shumë i lartë dhe pikëzimi 15 dhe 10 pikë.

Në lidhje me “Gatishmërinë e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja e tij në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës penale, janë gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 32 ditë, kohëzgjatja e të cilave është brenda kufijve 15-120 ditë për gjithë periudhën 3-vjecare, prandaj në këto kushte propozohet niveli i pikëzimit 20 pikë për këtë gjyqtar.

“Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional” nuk është provuar. Pra nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës prandaj niveli i pikëzimit lidhur me këtë komponent do të jetë 3 pikë.

Për të kaluar tek “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhënie me publikun”, fillimisht në

projektraport ky komponent është vlerësuar me 3 pikë. Por duke qenë se në kundërshtimet e tij lidhur me nivelin e pikëzimit të këtij kriteri gjyqtari ka paraqitur edhe prova shtesë, kam vlerësuar që pjesëmarrja në dy konferenca shkencore si referues me dy artikuj, të vlerësohet, pra të merret në konsideratë lidhur me nivelin e pikëzimit lidhur me këtë tregues. Kështu që për treguesin “pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale” propozoj që të kemi një ndryshim për sa i përket nivelit të pikëzimit nga 3 në 5 pikë.

Për sa i takon “Publikimeve ligjore akademike” edhe në lidhje me këtë aspekt provohet se gjyqtari ka kontribute të tilla, kështu që është vlerësuar që ky komponent të vlerësohet në nivelin e 5 pikëve.

Kështu që lidhur me propozimin për nivelin e vlerësimit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” për gjyqtari {...} të jetë niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 98.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit lidhur me këtë gjyqtar është i tillë:

“Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësitë organizative të gjyqtarit”, pikët 98, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikët 98, vlerësimi “Shkëlqyeshëm”.

Përfundimisht vlerësimi i përgjithshëm për këtë gjyqtar është niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 396.

Faleminderit për vëmendjen!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Rupa!

Siç ju e theksuat, keni reflektuar në një vlerësim ndryshe nga çfarë është parashtruar duke marrë në konsideratë edhe kundërshtimet e z. {...}.

Ka diskutime nga anëtarët?

Po, zoti Kurushi!

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, dëgjuam relatorin në lidhje me prezantimin e raportit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit z. {...}. Në ndryshim nga ajo çfarë është paraqitur me shkrim, dakordësohem edhe me propozimin e fundit që relatorja bëri në seancën e sotme duke shtuar edhe dy pikë të tjera, referuar treguesit të marrëdhënieve ndërinstitucionale të gjyqtarit, më falni, kontributeve ndërinstitucionale të gjyqtarit si dhe marrëdhëniet me publikun; përveç kësaj situatë dhe këtij propozimi unë dua që të bëj një propozim tjetër të ri për të ndryshuar edhe një tregues tjetër, që i referohet raportit të paraqitur dhe pikërisht i referohem treguesit “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”. Nga relatorja është propozuar 8 pikë, ndërkohë që unë bëj një propozim që përveç 8 pikëshit dhe nivelin e vlerësimit “shumë mirë”, të ndryshohet niveli duke i shtuar edhe dy pikë të tjera dhe të shkojë në nivelin e vlerësimit “shkëlqyeshëm”. Arsyeja pse e bëj këtë propozim. Shikoj që numri i çështjeve të gjykuara nga gjyqtari në periudhën e vlerësimit, si relator ka përfunduar brenda kësaj periudhe 423 nga 438 çështje total. Kështu që, në këtë pikë, ekzistojnë disa rrethana të cilat nuk varen nga vullneti i gjyqtarit për të ndikuar po themi pozitivisht në punën e tij, dhe cilat janë këto: i) unë shoh që në relacion me të drejtë është konstatuar fakti që ka një mungesë të dhënash në tabelat statistikore; ii) shoh gjithashtu që natyra e çështjeve të mbartura është e tillë që lidhet me elementët e tillë si kompleksiteti i çështjes, me kushtet e punës së gjyqtarit dhe me vështirësinë që krijohet gjatë drejtimit të seancave gjyqësore dhe përfundimit të çështjeve në kohë. Gjyqtari në këtë rast, në kundërshtimet e tij, ka paraqitur që katër çështje kanë përfunduar jashtë afatit kohor, sepse me të drejtë, një pjesë e tyre janë hedhur në short në fund të muajit dhjetor dhe hedhja e çështjeve në short në fund të muajit dhjetor, kur çështjet kanë natyrë komplekse me akuza të rënda, siç janë vrasje, vrasje në familje, siç janë rrëmbim personi me pasojë vdekjen e tij, të hedhura në muajin dhjetor, e bëjnë të pamundur që këto çështje të përfundojnë brenda muajit. Duke shtuar këtu edhe nenin 333 të Kodit të Procedurës Penale i njehtë drejtën gjyqtarit që të caktojë seancën e parë gjyqësore brenda afatit 10-ditor dhe duhet t’i japi kohë palëve jo më pas se 10 ditë për t’u njohur me materialet e çështjes. Në këtë rast pra, sikur të marrim situatën më të mirë prej 20 ditësh, e ka të pamundur gjyqtari që të shqyrtojë çështjen me kompleksitet, me pyetje dëshmitarësh, me marrje provash, me pyetje të pandehurish dhe për ta mbyllur çështjen brenda një afati njëmuajor. Pra thashë, kompleksiteti, mungesa e të dhënave statistikore

është një rrethanë që nuk varet në vullnetin e gjyqtarit në këtë rast.

Nuk i krijon gjyqtari tabelat statistikore.

Në këtë pikë edhe diferenca e çështjeve të përfunduara me çështjet e regjistruara që është diku tek 15 çështje nuk është e tillë që gjyqtarin ta vlerësojmë në treguesin e rendimentit me 8 pikë sepse thashë, evidentova kompleksitetin e çështjeve si dhe kushtet e punës ku është gjendur gjyqtari në shqyrtimin e këtyre çështjeve, flas muajin dhjetor që është muaji i fund vitit dhe ai e ka të pamundur të shqyrtojë këto çështje. Kështu që, në mënyrë të përmbledhur, duke marrë në konsideratë këto rrethana që unë i përmenda, unë propozoj që për këtë tregues gjyqtarit t'i shtohen edhe dy pikë dhe nga propozimi prej 8 pikësh, për treguesin 2.A.ç. "Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore" gjyqtari të vlerësohet me 10 pikë.

Ndërsa me propozimin e bërë nga zonja Rupa, siç e thashë edhe më përpara, jam dakord për shtimin e dy pikëve për treguesin e kontributeve ndërinstitucionale. Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Kurushi!

Po zonja Ukperaj!

***Brikena Ukperaj:*** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Lidhur me propozimin e relatores për rritjen e shkallës së pikëzimit tek veprimtaritë ndërinstitucionale edhe unë jam dakord, sepse kanë rezultuar prova të reja, të cilat nuk ishin në dijeni të relatores në momentin që ka hartuar projektraportin e vlerësimit.

Për sa i përket rendimentit të përfundimit të çështjeve, së pari është e ndaluar në ligj që ne të administrojmë vendime gjyqësore në një procedurë vlerësimi. Gjyqtari mund të sjellë prova të reja me përjashtim të vendimeve gjyqësore, parashikon ligji, për t'u administruar si prova. Megjithatë, gjyqtari ka sjellë katër vendime gjyqësore, jo për efekt të vlerësimit të aftësive të tij profesionale por për efekt të aftësive organizative sepse në vendime gjejmë të pasqyruar datën e shortit dhe datën e dhënies së vendimit.

Po, jam dakord që për ish-Gjykatën e Krimeve të Rënda një çështje e shortuar në nëntor apo dhjetor është në pamundësi për shkak të kompleksitetit dhe numrit të të

pandehurve që të përfundojë brenda dhjetorit. Por edhe nëse ne do të prananim kundërshtimet e gjyqtarit dhe do t'i shtonim këto katër çështje ose do t'i zbrisnim këto katër çështje si çështje të caktuara, pra nuk do të ishin 438, por do të ishin 434 çështje të caktuara, në një analizë matematikore, përsëri rendimenti do të dilte poshtë 99%.

Në të gjitha rastet që Këshilli ka vlerësuar gjyqtarët e kësaj gjykate, në të gjitha rastet është lënë rendimenti i përcaktuar nga procesi i rivlerësimit kalimtar. Edhe pse gjyqtarët na kanë bërë kundërshtime me të njëjtat argumentime që zoti Kurushi ngriti sot, ne në asnjë rast nuk kemi bërë ngritje të pikëzimit, madje-madje kemi pasur gjyqtarë edhe me 98.6%, me një rendiment më të lartë, edhe ata kështu kanë pretenduar, për shkak të kompleksitetit. Pse? Po të shikoni, 423 çështje nuk janë çështje vetëm si relator, janë çështje edhe si anëtar i trupit gjykues (për tre vjet). Pra ne nuk dimë se sa ka pasur çështje si relator. Dhe ne kur llogarisim rendimentin, e llogarisim vetëm rendimentin e gjyqtarit si relator dhe jo se s'ka pasur të dhëna statistikore, por të dhënat statistikore për efekt të procesit të rivlerësimit janë mbledhur në këtë mënyrë, janë shfrytëzuar në procedurën e gradimit. Për këtë arsye nuk është 423 çështje të gjykuara nga zoti {...} si relator, është si relator dhe trup gjykues. Në asnjë rast nuk i kemi marrë këto në analizë. I kemi marrë për gjykatën e apelit kur kemi justifikuar rritjen me një shkallë të rendimentin sepse gjyqtari ka qenë i angazhuar edhe në shumë trupa gjykues. Por për gjyqtarin e krimeve të rënda kur ne nuk dimë në fakt se sa kanë qenë nga këto si relator, në këtë moment nuk është e përcaktuar këtu. Nuk është faji i tij, por mund t'i sillte edhe si prova bashkëngjitur.

Nuk është vetëm ky problem, problemi është që ne duhet të zbatojmë të njëjtin standard për të gjithë gjyqtarët zoti Kurushi. Nuk mund të zbatojmë standarde të ndryshme për gjyqtarë të ndryshëm. Për sa kohë, aq më tepër që kjo gjykatë ka vërtetë kompleksitet të çështjeve, por ka edhe një standard sasior më të ulët të përcaktuar për gjyqtar, sesa gjyqtarët e gjykatës së apelit, sepse çështja është shumë komplekse. Asnjë nuk e vë në dyshim. Për këtë arsye unë jam dakord me propozimin e relatores dhe mendoj që për të respektuar standardin aq të dëshiruar në vlerësime dhe shlyqyr që e kemi këtë standardin objektiv, për të qenë edhe transparent, mendoj që në këtë rast nuk mund të aplikojmë një shkallë më të lartë pikëzimi.

*Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!*

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, atëherë vazhdojmë me votimin e propozimit të zotit Kurushi në lidhje me rubrikën “Aftësitë organizative” dhe konkretisht seksioni “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, pika ç. “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, propozohet nga zoti Kurushi një vlerësim nga 8 në 10 pikë, duke u shtuar 2 pikë.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord, me argumentat që tha z. Kurushi.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Kundër.

**Brikena Ukperaj:** Kundër.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Miratohet propozimi i zotit Kurushi.

**Ilir Rusi:** Atëherë, kalojmë në miratimin e projektvlerësimit përfundimtar të tij, duke marrë në konsideratë edhe reflektimet që u bënë nga zonja Rupa dhe miratimi së fundi i propozimit të zotit Kurushi.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën 2013-2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
- Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 08.11.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...} për periudhën 2017-2019”, i përgatitur nga relatore znj. Yllka Rupa.

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:42 dhe mbaroi në orën 15:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

***Shënim 1:*** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Irena Plaku dhe znj.



*Marçela Shehu.*

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**

**5. Valbona Bala, eksperte (EWMI).**

**6. Sarmela Titka, përfaqësuese Ambasada Amerikane.**

**7. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**

**8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

## **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...} për periudhën 2017–2019”, i përgatitur nga relatore znj. Yllka Rupa.

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 2 të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017–2019”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Rupa. Për më tej fjalën zonja Rupa.

*Yllka Rupa:* Faleminderit!

Në cilësinë e relatores do të prezantoj edhe konkluzionet lidhur me vlerësimin e gjyqtares {...} për periudhën 2017–2019. Projektraporti përmban të plotë procedurën. I është komunikuar gjyqtares niveli i vlerësimit dhe pikëzimit. Nuk ka paraqitur kundërshtime, kështu që në mënyrë të përmbledhur do të ndalem në analizën e gjithsecilit nga katër kriteret e vlerësimit lidhur me këtë gjyqtare.

Për sa i takon “Aftësive profesionale të gjyqtares”, “Njohuritë ligjore”, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës konkrete procedurale dhe

materiale që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin dhe arsyetimin e analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Në lidhje me këtë nëntregues propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Për të kaluar tek “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente duke i zërthyer paraprakisht elementët përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet një kujdes i shtuar i gjyqtarës për identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese, dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në lidhje me këtë nëntregues, propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25 pikë.

Për të kaluar tek “Arsyetimi ligjor”, “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit. Përgjithësisht gjyqtarja përdor fjali me gjatë mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Në lidhje me këtë tregues “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, vlerësohet nivel shumë i lartë i gjyqtarës dhe pikëzimi me 15 pikë.

Për të kaluar tek “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, në tërësi referuar burimeve evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i

lartë, pikëzimi 10.

Në lidhje me “Cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik” rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta për këtë tregues. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin fakt–normë–interpretim–konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtares në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në këto kushte propozohet niveli shumë i lartë i vlerësimit, pikët 25.

Kështu që propozimi lidhur me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, propozohet të jetë niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë organizative”. Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësitë e gjyqtares në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës i cili tregon sa mirë gjyqtar përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerët.

Në lidhje me kriterin e aftësive organizative, pikësëpari vlerësohet aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë, në aspektin e “Respektimit të afateve ligjore”. Sipas të dhënave të pasqyruara në raportin analitik rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 627 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 441 çështje janë shqyrtuar jashtë afatit ligjor dhe 192 janë shqyrtuar brenda këtij afati.

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhëna statistikore por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit.

Si rezultat i verifikimit të të dhënave statistikore për periudhën 01.01.2017–31.12.2019 duke zbritur çështjet për të cilat vonesat nuk kanë qenë përgjegjësi e gjyqtares, pasi janë një pjesë e konsiderueshme e çështjeve janë shortuar shumë ditë pas datës së regjistrimit, ditë që variojnë nga 4–8 apo 16 ditë pasi çështjet ishin të regjistruara, rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 627 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 374 çështje janë shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

Sipas metodologjisë së pikëzimit kjo e shprehur në përqindje 59.6% e çështjeve jashtë afatit ligjor, vlerësohet me 3 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar qartë hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve dhe këtu vlen të përmendet se gjyqtarja ka gjykuar çështje të natyrës civile dhe tregtare, dy kategori që kanë një impenjim për sa i përket edhe ngarkesës së madhe dhe sa i përket angazhimit në kryerjen e veprimeve procedurave në afat, por gjithashtu vlerëson edhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së saj, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares.

Vetë fakti i të qenit gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nënkupton një ngarkesë shumë të madhe çështjesh të regjistruara në këtë gjykatë dhe në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja {...}, ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi 1351 çështje, nga të cilat 627 çështje parashikojnë afat ligjor gjykimi. Pra, 46.4% e numrit total të çështjeve kanë qenë me afat ligjor, përqindje tepër e lartë duke e ngarkuar gjyqtaren me çështje që kërkonin shpejtësi gjykimi. Gjithashtu, rezulton se nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 616 çështje janë me palë kundërshtare.

Duke marrë në konsideratë të gjitha këto parashtrime të cilat i mundëson edhe përcaktimi që bën metodologjia e pikëzimit të gjyqtarit lidhur me këtë tregues, është vlerësuar që pikëzimi lidhur me respektimin e aftëve ligjore të jetë 12 pikë për këtë gjyqtare.

Për të kaluar tek “Plotësimi i standardeve minimale kohore”, sipas të dhënave të pasqyruara në raportin analitik rezulton se nga 724 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 238 prej tyre apo 32,87% janë gjykuar jashtë afatit standard minimal kohor. Në disa raste, vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja, përkatësisht në muajt gusht të viteve 2017, 2018, 2019 dhe nëse në përllogaritjen e aftit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore ose ditët e festave zyrtare, atëherë do të kishte një rendiment tjetër lidhur me respektimin e standardit minimal.

Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor do të përjashtoheshin çështjet e analizuara, atëherë do të rezultonte që nga 724 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 215 prej tyre ose 29,6% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të standardit minimal kohor, në raport me numrin total të çështjeve të gjykuara, kohës relativisht të shkurtër të tejkallimit të standardit minimal kohor në disa çështje të analizuara (nga 1 deri në 3 ditë) sipas të dhënave statistikore, po kështu duke marrë në konsideratë faktin se gjyqtarja ka gjykuar një numër të konsiderueshëm çështjesh të përfunduara në tre vite prej 1351 çështje në total, vlerësoj që në lidhje me këtë tregues gjyqtarja të jetë në nivelin e pikëzimit prej 5 pikëve.

Në lidhje me “Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit si dhe në krahasim të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi, për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është dukshëm më e shkurtër se ky afat nga 4 për 5 kategoritë e çështjeve. Koha mesatare është më e gjatë se standardi vetëm për një kategori çështjesh. Gjithashtu duke marrë në konsideratë faktin se gjyqtarja ka një ngarkesë tepër të lartë të çështjeve të shqyrtuara, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pra duke u rritur me një nivel, nivelin e 5 pikëve.

Për sa i takon “Rendimentit të përfundimit të çështjeve gjyqësore”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 89,1% por ndërkohë rezulton se ajo e ka tejkalluar standardin sasior për çështjet e themelit përfunduar në masën 71,1%, kështu që propozoj në lidhje me këtë tregues nivelin e pikëzimit me 10 pikë.

Në lidhje me “Kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, rezulton që është vlerësuar edhe në lidhje me këtë komponent të vlerësohet me pikët maksimale pasi rezulton që koha e arsyetimit të vendimit është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për shumicën e kategorive të çështjeve dhe gjyqtarja për këtë tregues duke pasur në konsideratë dhe vlerësuar të gjitha situatat të cilat mund të

kenë ndikuar në mënyrë objektive në punën e gjyqtares, vlerësohet që lidhur me këtë tregues të pikëzohet në nivelin e 15 pikëve.

Për sa i takon “Aftësive të gjyqtarit për të kryer procedura gjyqësore”, referuar të dhënave që rezultojnë nga zhvillimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3,7 seanca duke e tejkaluar me 0.7 %, tejkallim i cili vlerësohet i papërfillshëm duke marrë në konsideratë problematikat e përmendura më sipër, prandaj për gjyqtaren subjekt vlerësimi, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet në një nivel më të lartë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

Në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, në tërësi referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 20.

Për sa i takon “Aftësisë së gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”, vlerësohet pikëzimi maksimal i saj në të dy komponentët.

Kështu që lidhur me propozimin për nivelin e vlerësimit të kriterit “Aftësitë organizative të gjyqtares”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 96.

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, për të gjithë komponentët që i referohen këtij kriteri, propozohet të vlerësohet në nivelin "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”, lidhur me këtë gjyqtare, për sa i takon komunikimit të qartë dhe transparent në tërësi nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme. Në këto kushte propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikët 25.

Për sa i takon “Respektimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale, për rrjedhojë prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal.

Propozohet niveli i vlerësimit i lartë, pikëzimi 15.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, shfaqet në nivele të mira, si në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, ashtu edhe në aspektin e shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore. Kështu që përkatësisht për të dyja këto komponentë propozohet vlerësimi me 15 dhe 10 pikë.

Në lidhje me “Gatishmërinë e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, sa i takon “Pjesëmarrjes së saj në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese përkatësisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluar për 44 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare. Në lidhje me këtë tregues propozohet niveli i pikëzimit 20 pikë.

Në lidhje me “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional”, provohet që gjyqtarja sipas informacionit të përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, ka marrë pjesë në cilësinë e lehtësuese në 7 aktivitete trajnuese për gjyqtarë, kështu që vlerësohet që ky tregues të propozohet të pikëzohet me 5 pikë.

Gjithashtu edhe angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata, propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë, pasi provohet që gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete të tilla gjithashtu provohet që edhe gjyqtarja ka publikime ligjore, kështu që në lidhje me këto tregues propozohet pikëzimi me 5 pikë i gjyqtarës.

Në mënyrë të përmbledhur propozimi për nivelin e vlerësimit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional për gjyqtaren”, propozohet të jetë pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për të gjitha kriteret mbi bazën e të cilave përcaktohet niveli i përgjithshëm i vlerësimit për gjyqtaren {...}, propozohet të jetë niveli i vlerësimit dhe i pikëzimit si më poshtë:

Kriteri “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësitë organizative të gjyqtares”, pikët 97, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, pikët 100, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, pikët 1100, vlerësimi “Shkëlqyeshëm”.

Pra propozoj në lidhje me këtë gjyqtare nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 397.

**Ilir Rusi:** Faleminderit zonja Rupa!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017–2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, të gjyqtares {...}, për periudhën 2017–2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe



është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 08.11.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:42 dhe mbaroi në orën 15:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>1</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërta sipas rendit të ditës.

**Shënim 1:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku dhe znj. Marçela Shehu*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI).**
- 7. Sarmela Titka, përfaqësuese Ambasada Amerikane.**
- 8. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë, sikundër edhe e theksuam, pika 3 do të trajtohet në një mbledhje të ardhshme për shkak të mungesës së relatores znj. Plaku. (*shih procesverbalin e pikës së parë.*)

*Ilir Rusi:* Vazhdojmë me pikën 4 të këtij rendi dite, që ka të bëjë me shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Do të raportohet nga Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, zonja Petriti.

Fjala për ju zonja Petriti.

**Etrita Petruti:** Të nderuar, me ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, Këshillit të Lartë Gjyqësor, iu akorduan 1759 punonjës, nga të cilët sipas detajimit që do ta pasqyrojmë edhe më poshtë, 138 punonjës për institucionin e KLGJ-së, 6 punonjës për Qendrën e Teknologjisë së Informacionit të Sistemit të Drejtësisë (QTI) dhe 1615 punonjës për pushtetin gjyqësor.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore në propozimin për detajimin e numrit të punonjësve është mbështetur në mbështet në: Projektin e hartuar për nevojat e burimeve njerëzore, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në implementimin e hartës së re gjyqësore, bazuar në VKM nr. 495/2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”; Situatën e numrit të punonjësve, kërkesat e gjykatave, nevojat e krijuara për staf administrativ në përfundim të implementimit të hartës së re gjyqësore, si dhe sigurimin e funksionalitetit të strukturës organizative, referuar ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, neni 12 dhe neni 13.

Shkurtimisht paraqes përpara jush detajimin e propozuar për detajimin e numrit 30 të pozicioneve të punës, prej të cilave referuar kërkesës së ardhur nga Departamenti i Organizimit të Gjykatave dhe nga Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit, jemi referuar dhe kemi propozuar për detajim 8 pozicione për Drejtorinë e IT-së, 2 pozicione për Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit.

Kërkesat janë shoqëruar me argumentet e të dy drejtorive. Drejtoria e IT dhe Menaxhimit të Çështjeve kërkon një riorganizim të drejtorisë. Pra nga dy sektorë, kërkon të riorganizohet në katër sektorë dhe numri total do të jetë me një shtesë prej 8 pozicionesh. Gjithashtu kjo drejtori ka dhënë argumentet e veta mbështetur në përmbushjen e qëllimit që kanë sistemet e gjykatave dhe në veçanti në sistemin e menaxhimit të çështjeve.

Gjithashtu Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit pranë Këshilli të Lartë Gjyqësor, ka paraqitur në rrugë elektronike, por edhe në rrugë zyrtare një kërkesë për shtimin e 1 (një) pozicioni Specialist në Sektorin e Financës dhe 1 (një) pozicion Specialist në Sektorin e Buxhetit, në lidhje me përdorimin e sistemeve tashmë sipas Udhëzimit nr. 2 të vitit 2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pra në total nga 30 pozicione të detajuara, 10 pozicione kemi propozuar të detajohen për Këshillin e Lartë Gjyqësor, më konkretisht: 8 për Drejtorinë e IT dhe Menaxhimit të Çështjeve dhe 2 pozicione për Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit të Buxhetit. Në përfundim, 20 pozicione të mbetura pra kemi propozuar t'i detajojmë për gjykatat, por më konkretisht referuar ligjit nr. 10296/2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollit, gjithashtu edhe kërkesës së drejtorisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kemi propozuar të detajojmë pozicion specialist buxheti dhe finance në disa prej gjykatave, të cilat pas implementimit të hartës gjyqësore nuk e kanë të specifikuar këtë pozicion apo janë në mungesë. Më konkretisht: Gjykata Administrative e Apelit; Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat; Elbasan; Lezhë dhe Sarandë, pra pesë pozicione “specialist buxheti dhe finance”. Ky propozim ka ardhur edhe nga verifikimi i strukturave organizative të gjykatave të cilat rezultojnë se pozicioni “shef sektori, specialist buxheti/finance” është miratuar me vendim të gjykatave, pra për këto gjykata nuk kemi propozuar detajim të këtij pozicioni; por edhe nisur nga numri i vogël i pozicioneve tashmë të mbetura për t'u detajuar nëpër gjykata.

Gjithashtu, referuar pozicionit “sekretar gjyqësor”, aktualisht ky pozicion është i plotësuar me 398 punonjës për 292 gjyqtarë, të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit. Kemi paraqitur tabelë përmbledhëse nisur nga numri i magistratëve dhe pozicionit të sekretareve.

Nga analiza aktuale e strukturave organizative të miratuara, rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Elbasan dhe Fier, numri i strukturës organizative të pozicionit “sekretar gjyqësor” është më i ulët se numri i strukturës organizative të magistratëve (gjyqtarë) të miratuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Siç u përmend më lart, referuar emërimeve, që tashmë janë realizuar, të 40 magistratëve (gjyqtarë), numrit të çështjeve të regjistruara nga data 1 janar 2023, të vëna në dispozicion nga strukturat funksionale në KLGJ, konkretisht Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (1367), Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan (3517) dhe Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (3806), nisur edhe nga ngarkesa të konsiderueshme të punës, kemi propozuar detajimin e 3 (tre) pozicioneve sekretar/e gjyqësor/e në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Elbasan dhe Fier.

Gjithashtu, nga Gjykata Administrative e Apelit, referuar implementimit të hartës gjyqësore ku Këshilli i Lartë Gjyqësor në përfundim të këtij procesi ka përcjellë për unifikim pranë gjykatave të gjitha strukturat, Gjykata Administrative e Apelit, aktualisht është në proces për hartimin dhe miratimin e strukturës organizative por ndodhur në kushtet e mungesës së pozicioneve, ende nuk ka miratuar strukturën dhe ka referuar përpara KLGJ-së kërkesën për detajim të pozicioneve:

1 Drejtor, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Shef Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, prokurime; Specialist i burimeve njerëzore; Specialist i shërbimeve mbështetëse; prokurime; Shef Sektori IT, statistike dhe marrëdhënie me publikun; Specialist IT-je; Shef Sektori protokoll-arkive dhe 1 Specialist protokoli. Pra gjithsej 9 pozicione, të cilat do të ishin të nevojshme për miratimin e strukturës dhe funksionalitetin e saj.

Gjithashtu Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, ndodhur në kushtet kur volumi i punës pranë kësaj gjykate është mjaft i lartë dhe funksionimi i sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Statistika, Marrëdhënie me Publikun vijon vetëm me 2 specialistë, më konkretisht “Specialist IT” dhe një pozicion “Specialist marrëdhënie me publikun”, referuar ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, për përbërjen e një strukture organizative funksionale propozohet të detajohet një pozicion “Shef sektori IT, statistikë dhe marrëdhënie me publikun”.

Gjithashtu referuar numrit të çështjeve 1396 të vëna në dispozicion nga struktura funksionale, volumit të punës dhe numrit të strukturës organizative, kemi propozuar detajimin e një pozicioni “Specialist protokoli”.

Për sa më lart, propozohet detajimi i dy pozicioneve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat: 1 “Shef sektori IT, statistikë dhe marrëdhënie me publikun” dhe 1 “Specialist protokoli”.

Gjithashtu Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, referuar ngarkesës aktuale, numrit të strukturës organizative, ngarkesës së çështjeve pranë kësaj gjykate, në kuadër të rritjes së funksionalitetit të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, propozohet detajimi i 1 (një) pozicioni “Specialist i statistikës”.

Në total kemi detajimin e 30 pozicioneve, prej të cilave 20 të propozuara për t'u detajuar nëpër gjykatat e sipërcituara dhe 10 pozicione propozohen për t'u detajuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit.

**Ilir Rusi:** Faleminderit zonja Petriti!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

**Alban Toro:** Po, kam unë pyetje.

**Ilir Rusi:** Po zoti Toro, fjala për ju!

**Alban Toro:** Pyetjet konsistojnë kryesisht për Drejtorinë e IT-së dhe Menaxhimit të Çështjeve dhe pastaj do të kaloj tek Gjykata Administrative e Apelit.

Rezulton që aktualisht kjo drejtori ka tre drejtues (pra 1 drejtor, 2 shefa dhe 4 specialistë). Në mos gaboj. Propozohet tani që të shtohen edhe 2 drejtues të tjerë (2 shefa) plus 6 specialistë. Pse është kaq emergjente apo e nevojshme shtimi i niveleve të drejtuesve që në raport me specialistët shkojnë 5 me 12? Pra duket sikur ka më tepër nevojë për drejtues sesa për specialistë. Ndërkohë që, besoj se edhe 3 drejtues mund ta drejtojnë, organizojnë atë grup të vogël prej 12-15 vetash. Pra nuk do të ishte shumë e nevojshme ekzistenca e drejtuesit kur ju shtroni që nevojat më të mëdha janë për specialistë.

**Etrita Petriti:** Pa analizuar edhe më tej arsyet e dhëna nga drejtori i departamentit përse është bërë shtesa ose riorganizimi i kësaj drejtorie, dua të theksoj se kalojmë aktualisht funksionalë 2 sektorë në 4 sektorë dhe për zbatimin dhe funksionalitetin e një strukture (sipas edhe ligjit 90) duhet që në qoftë se kemi të bëjmë me një drejtori të sheshtë (që aktualisht nuk jemi përballë një drejtorie të sheshtë se kemi sektorë), do të ishte një drejtor dhe specialistë, por aktualisht jemi në drejtorinë që duhet të jetë funksionale me sektorë. Sektori që të jetë funksional duhet të ketë edhe një "shef sektori" plus specialistët e vet (dy edhe më tepër). Për këtë arsye, ndodhur në faktin që ne do të

riorganizojmë këtë strukturë nga dy sektorë në katër sektorë, automatikisht nga dy shefa sektori do të kemi katër shefa sektori për funksionimin e kësaj drejtorie dhe më pas sipas edhe detajimit të bërë nga vetë drejtori i departamentit, numrat respektivë të pozicioneve të specialistëve.

**Alban Toro:** Po prapë bëjnë 5, 5 drejtues dhe 12 specialistë.

Është pak disproporcionale.

**Etrita Petriti:** Kemi katër sektorë që normalisht për të qenë funksionalë duhet të kemi katër shefa sektorësh, konkretisht sektor menaxhim, projektet, serverat etj., Ndërsa pozicioni i drejtorit i pesti, ose i pari dhe më pas na vijnë katër shefa sektorësh, normalisht është pozicion...

**Alban Toro:** E pse mos të bëhet për shembull që një shef sektori të drejtojë dy sektorë?

**Etrita Petriti:** Sepse nuk e lejon ligji 90 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës.

**Alban Toro:** Cili nen nuk e lejon këtë pjesën e...?

**Etrita Petriti:** Neni 12 dhe 13 (“funksioni i drejtorisë” dhe “funksionimi i sektorit”). Një sektor duhet të ketë shef sektori dhe specialistë.

*(Zoti Toro konsultohet me nenet e sipërcituara.)*

**Ilir Rusi:** Po zoti Toro, në lidhje me diskutimin tuaj.

**Alban Toro:** Në lidhje me diskutimin, u sqarova, u konsultova në mënyrë shteruese, kështu që vijojmë.



***Ilir Rusi:*** Ju faleminderit!

Ka diskutime të tjera?

Atëherë, meqenëse parashtrësa e zotit Toro gjeti orientim po përgjatë diskutimeve përkatëse, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

***Dritan Hallunaj:*** Pro.

***Ridvan Hado:*** Dakord.

***Alban Toro:*** Dakord.

***Fatmira Luli:*** Dakord.

***Yllka Rupa:*** Pro.

***Brikena Ukperaj:*** Pro.

***Klodian Kurushi:*** Dakord.

***Ilir Rusi:*** Dakord.

Vendim “Për detajimin e numrit të punonjësve për vitin 2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të bazës ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të miratojë detajimin e numrit të punonjësve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe njësisve shpenzuese në varësi të saj i përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2023, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për vijimin e procedurave të njoftimit të gjykatave dhe ndryshimet strukturore të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 08.11.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:42 dhe mbaroi në orën 15:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <b>(anëtare)</b>         |

<sup>2</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta sipas rendit të ditës.

**Shënim 1:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku dhe znj. Marçela Shehu*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Xhavadet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.**
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala, eksperte (EWMI).**
- 7. Sarmela Titka, përfaqësuese Ambasada Amerikane.**
- 8. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 9. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare””, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Ilir Rusi:** Më tej vazhdojmë me pikën 5 të këtij rendi dite që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare””, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej relatimi nga Drejtori i Ekonomisë, zoti Haxhiu.

**Xhevdet Haxhiu:** Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijëni, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare” me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, ka udhëzuar si më poshtë:

1. Gjyqtari që ushtron funksionin në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, përfiton shtesë page në masën 50% të pagës së tij ditore.

2. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe/ose gjyqtari i gjykatës së apelit kompensohet financiarisht sipas pikës 1, vetëm nëse gjykon çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24–72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.

3. Në çdo rast gjykata duhet të ketë fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të saj.

4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij udhëzimi, fillojnë në datën 1 janar 2019.

Në këtë udhëzim është parashikuar që në mbështetje të nenin 11, pika 3, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenit 91 të Kodit të Punës të Republikën e Shqipërisë, gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit që ushtrorjnë funksionin në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, duhet të përfitojnë shtesë page në masën 50% të pagës së tyre ditore.

Për shkak të natyrës së çështjeve të ngutshme që shqyrton gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, e lidhur kjo ngushtësisht me afatet kohore të parashikuara në ligj, në këtë udhëzim është parashikuar pa bërë ndonjë diferencim në trajtim midis gjyqtarëve të dy shkallëve, se ata do të kompensohen financiarisht si më sipër, vetëm nëse i duhet të gjykojnë në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.

Në lidhje me këtë çështje vlerësohet se situata aktuale dikton kryerjen nga Këshilli të një vlerësimi të ri dhe të ndryshëm të rrethanave, të cilat kanë përcaktuar përmbajtjen e Udhëzimit nr. 38, datë 28.02.2019, në momentin e miratimit të tij. Me anë të këtij Udhëzimi, Këshilli kushtëzoi kompensimin financiar të gjyqtarit, në formën e shtesës së pagës në masën 50% të pagës së tij ditore, me klauzolën që ai duhet të

gjykonte, në ditët e pushimit javor apo festave zyrtare, çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.

Duke u bazuar në organizimin e tanishëm të sistemit gjyqësor, të gjykatave të apelit dhe të shkallës së parë, konstatohet dhe vlerësohet ekzistenca e një situatë të ndryshme juridike dhe faktike, e cila ka nxjerrë në pah nevojën për të ndërhyrë dhe ndryshuar parashikimin e Udhëzimit nr. 38, datë 28.02.2019, “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare”, ndryshim i cili lidhet me trajtimin financiar të gjyqtarëve, të cilët janë në listën e gatishmërisë gjatë ditëve të pushimit javor apo të festave zyrtare, por nuk zhvillojnë dhe gjykojnë çështje urgjente.

Konkretisht, konstatohet se me vendimin me nr. 495, datë 21.07.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”<sup>1</sup>, Këshilli i Ministrave ka vendosur riorganizimin e gjykatave të apelit dhe të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm si dhe të atij administrativ, duke sjellë funksionimin, sipas afateve të përcaktuar në këtë vendim, të 13 gjykatave të rretheve gjyqësore, 2 gjykatave administrative të shkallës së parë dhe të 1 gjykate apeli të juridiksionit të përgjithshëm. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ka filluar funksionimin e saj më datë 01.02.2023, me 78 (shtatëdhjetë e tetë) gjyqtarë, numër i caktuar për këtë gjykatë me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, referuar përcaktimeve detyruese të nenit 15, pika 4 të Ligjit nr.98/2016 “Për pushtetin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM-së nr.495/2022, si dhe procesit që po kryhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për implementimin e Hartës së Re Gjyqësore, numri minimal i gjyqtarëve që do të gjykojnë në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm si dhe administrativ, nuk do të jetë tashmë, më i vogël se 7 (shtatë).

Pra, në kushtet kur për shkak të organizimit të ri gjyqësor, nuk ka më gjykata që kanë në përbërje të tyre 4 deri në 6 gjyqtarë, apo dhe një numër më të ulët të tyre, trajtimi financiar i gjyqtarëve bazuar në qenien e tyre në listën e gatishmërisë, çmohet se është në pajtim dhe nuk cenon parimin e trajtimit të barabartë të të gjithë gjyqtarëve referuar punës konkrete të kryer prej tyre.

Një nga argumentet që duhet të mbahet në konsideratë nga Këshilli në këtë rast,

lidhet me faktin se procesi i trajtimit të çështjeve urgjente, që i caktohen gjyqtarit për shkak të qenies së tij në listën e gatishmërisë, përfshin jo vetëm gjykimin e tyre, pra zhvillimin e seancës dhe marrjen e vendimeve përkatëse, por vlerësimin e vazhdueshëm dhe kompleks të situatave që lidhen me: (i) kryerjen dhe kontrollin e veprimeve procedurale të cilat përgatisin çështjen për gjykim, (ii) kohën që duhet t'i përkushtohet çdo çështjeje, për të realizuar misionin thelbësor të gjyqtarit atë të dhënies së drejtësisë, pra marrjes së një vendimi të drejtë, si dhe (iii) kohën dhe veprimet e nevojshme për përgatitjen e arsyetimit dhe depozitimit të vendimit përfundimtar brenda afateve ligjore, afate të cilat janë vlerësuar nga vetë ligjvënësi në raport me rëndësinë e veçantë që këto çështje kanë, për shkak të natyrës së tyre të kategorizuar si urgjente.

Mungesa e kompensimit financiar të gjyqtarëve që janë në listën e gatishmërisë, por që nuk gjykojnë çështje urgjente, është ngritur dhe nga Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve, e cila e ka konsideruar qëndrimin e Këshillit në miratimin e Udhëzimit në fjalë, si jo në pajtim me dispozitat ligjore dhe kushtetuese që rregullojnë statusin e magjistratit.

Mbështetur në situatën si më lart parashtruar, e cila ka afektuar, jo vetëm organizimin por dhe funksionimin e gjykatave si dhe, duke u bazuar në po të njëjtën analizë, mbi të dhënat financiare si dhe mbi numrin e seancave efektive gjyqësore të zhvilluara, vlerësohet se nuk konstatohet ndonjë trajtim i pabarabartë midis gjyqtarëve, referuar punës konkrete të kryer, në aspektin e ekzistencës së një disproporcioni midis punës së kryer dhe shpërblimit financiar që do të mund të përfitohej nga çdo gjyqtar.

Po kështu, vlerësohet se aktualisht nuk ka indikatorë të mjaftueshëm dhe objektivë për të arritur në përfundimin që ky lloj kompensimi financiar, të mund të kthehet në një element përcaktues e të qëndrueshëm të pagës së gjyqtarit, duke mos përlligjur qëllimin për të cilin ai duhej të akordohej.

Sa më lart, në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor ndryshimin e Udhëzimit nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare”, duke riformuluar pikën 2 të tij, me një përmbajtjen si më poshtë vijon:

“2. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe/ose gjyqtari i gjykatës së apelit kompensohet financiarisht sipas pikës 1, nëse është listën e gatishmërisë ose gjykon

çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24–72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.”

Ju faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Haxhiu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Po zonja Ukperaj, fjala për ju!

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, duke qenë se unë kam qenë relatore e Udhëzimit të mëparshëm që ka miratuar Këshilli, ka qenë një akt që ne kemi pasur debat që në kohën e miratimit të aktit në fakt. Gjithë debati ka qenë në faktin nëse gjyqtari që ka qenë në listën e gatishmërisë, por që nuk gjykon (nuk bën seanca gjyqësore) në ditët e pushimit zyrtar apo në festat zyrtare, duhet apo jo të marrë 50% të pagës. Ky ka qenë gjithë diskutimi.

Në atë kohë zoti Haxhiu, nuk e di nëse e sjellë në vëmendje apo në mend, ne kemi bërë një analizë financiare dhe na ka rezultuar nga analiza financiare që gjyqtarët e gjykatave të vogla, që në atë kohë kanë qenë me 2 ose 3 gjyqtarë (edhe me 1 gjyqtar), ata gjyqtarë gjykonin shumë pak masa sigurimi, por duke qenë se vazhdonte të aplikoheshin marrja e pagesës edhe kur nuk kishin seanca gjyqësore, paguheshin më shumë se gjyqtarët e gjykatave të mëdha të cilët gjykonin efektivisht mbi 10 masa sigurimi në ditë. Kemi bërë një analizë financiare (i është kërkuar në atë kohë zonjës Laze, për të marrë informacion nga gjykatat). Ka qenë zonja Laze që ka marrë informacion nga gjykatat në atë kohë dhe ai informacion i është bashkëngjitur relacionit që ne kemi përgatitur për mbledhje plenare.

Tani, në relacionin që ju po thoni dhe që arsyetoni se është e nevojshme ndryshimi i atij Udhëzimi, diku thuhet që: “...mbështetur në analizën e parashikuar si më lart në të cilat kanë afektuar, jo vetëm organizimin, por dhe funksionimin e gjykatave dhe duke u bazuar në po të njëjtën analizë, mbi të dhënat financiare si dhe mbi numrin e seancave efektive gjyqësore të zhvilluara...”, ka ndonjë studim për këto? Domethënë a keni marrë të dhëna financiare dhe numra seancash. “Vlerësohet se nuk konstatohet ndonjë trajtim i pabarabartë midis gjyqtarëve, referuar punë konkrete në aspektin e

ekzistencës së një disproporcioni midis punës së kryer dhe shpërblimit financiar që do të mund të përfitohet nga çdo gjyqtar.” Pra keni marrë ndonjë informacion nga gjykatat për të arritur në këtë konkluzion apo është thjesht i pasqyruar në relacion kjo gjë? Për të parë – vërtetë tani me hartën e re gjyqësore unë jam dakord që ka ndryshuar riorganizimi i gjykatave; nuk ka gjykata me më pak se 7 gjyqtarë; janë të plotësuara pothuajse të gjitha gjykatat – për të parë si shkon kjo çështje?! (Pyetja i drejtohet zonjës Luli si anëtare e Komisionit.)

**Fatmira Luli:** Jo, nuk ka asnjë studim. Është nisur thjesht nga riorganizimi i gjykatave dhe nga fakti që janë pyetur edhe grupet e interesit, kanë dhënë mendim shoqatat e gjyqtarëve, gjyqtarë dhe është gjykuar që për sa kohë gjyqtari do rrijë i gatshëm dhe është i angazhuar për të ndenjtur pranë gjykatës në kohën që do jetë në gatishmëri, duhet të paguhet. Është një e drejtë e tij të marrë shpërblimin për qëndrimin në dispozicion të punës pa pushuar fundjavave, të drejtën që ia ka dhënë ligji. Për këto arsye është bërë korrigjimi i atij akti të mëparshëm.

**Brikena Ukperaj:** Tani, dy anëtarë të Komisionit kanë qenë kundër në momentin që ne kemi miratuar këtë udhëzim, referuar procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të datës 28.02.2019. Sigurisht edhe zonja Luli këtë qëndrim ka mbajtur edhe kur është diskutuar Udhëzimi. U konsultova me përmbajtjen e procesverbalit, në ditën kur ne e kemi sjellë si propozim në plenare.

Unë mendoj që në këtë rast është e nevojshme për të pasur edhe ne një panoramë të gjithë situatës si është sot, qoftë mund të marrim një informacion, nga momenti i hyrjes së hartës në fuqi deri tani. Ka filluar harta, për apelin ka hyrë në shkurt, por për apelin kjo gjë nuk afekton pothuajse fare, sepse apeli e ka afatin 10-ditor të shqyrtimit të çështjeve të masave të sigurimit dhe ndërkohë këto kërkesat e ngutshme 48-ditore përfshihen brenda udhëzimit aktual pra nuk shtrohet shumë për apelin sesa shtrohet për gjykatat e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka filluar funksionimin në 1 maj 2023, mund të kemi, gjithashtu edhe për gjykatën e posaçme, e cila mund të ketë një numër shumë të madh çështjesh të shqyrtuara ditët e pushimit zyrtar ose edhe të festave zyrtare. Po, mund të ketë shumë. Mund të ketë procedime të lidhura, domethënë mund të ndodhë aty që të



gjithë gjyqtarët ndoshta mund të jenë në punë të shtunë, të diel. Prandaj, mund të kemi një panoramë të të gjithë situatës financiare nga maji deri tani se bëhet fjalë vetëm gjykatat e shkallës së parë, për të parë ecurinë sa ka qenë numri i seancave gjyqësore ose i çështjeve të shqyrtuara ditët e festave zyrtare, gjyqtarëve që kanë qenë në gatishmëri. Ose mund të bëni një listë të gjyqtarëve që kanë qenë në gatishmëri dhe çfarë përfitimi financiar kanë pasur. Ta marrim kështu. Sepse deri tani është zbatuar udhëzimi i vjetër dhe nëse është zbatuar udhëzimi i vjetër, ata janë paguar vetëm nëse kanë bërë seanca gjyqësore, apo jo? Kështu që, në qoftë se do të kemi numra gjyqtarësh dhe shpërblimet që ata kanë marrë vetëm për punët jashtë orarit për të parë dhe për ta krahasuar, a është kthyer në element përcaktues të pagës apo jo. Të marrim një informacion të tillë.

Së dyti, Këshilli ka edhe një vendim tjetër të rëndësishëm që ka marrë lidhur me kohën e punës së gjyqtarit. Ka qenë trajtimi i ankimit të një gjyqtareje të Gjirokastrës ndaj urdhrin të kryetarit (kryetarit në detyrë) i cili i hiqte ditë pushimi për shkak se gjyqtarja nuk respektonte orarin e punës (nuk shkonte në punë në ditë të caktuara). Aty Këshilli ka mbajtur një qëndrim të rëndësishëm dhe ka thënë që gjyqtari nuk ka kohë pune, nuk ka orar pune (më mirë të themi). Me të njëjtën logjikë, në mbledhjen e mëparshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, disa nga anëtarët kanë ngritur pretendimin që në fakt gatishmëria nuk është kohë pune, gatishmëria është një gjendje në të cilën gjyqtari qëndron në tentativë për t'u përfshirë në punë, sepse mund të të vijë çështje dhe mund të mos të vijë çështje. Shpërblimi që Kodi i Punës jep për orët jashtë orarit lidhet me punën efektive që kryhet në ditët e pushimit zyrtar. Për të gjitha këto unë mendoj që para se të jap një opinion lidhur me ndryshimin dhe nevojshmërinë për ta ndryshuar Udhëzimin, të marrë edhe këtë analizën financiare.

*Fatmira Luli:* Të them edhe unë dy fjalë.

*Ilir Rusi:* Po, zonja Luli!

Fjala për ju!

*Fatmira Luli:* I vetmi problem që ne kemi diskutuar kur është miratuar ai Udhëzim, ka qenë trajtimi i pabarabartë i gjyqtarëve dhe në ato rrethana bëhesh

përcaktuese kjo pagesë për gjykatat që ishin gjykata të vogla. Është një e drejtë legjitime që gjyqtari... bëhet fjalë për ditët e pushimit, nuk bëhet fjalë për kohë pune. Bëhet fjalë për të drejtën legjitime që kanë të tërë shtetasit që punojnë dhe që kanë kohën e pushimit dhe për këtë shkak, në kohën e pushimit, Kodi i Punës i cili reflekton pastaj edhe në tërë ligjet e tjera (sepse baza është ai) u ka dhënë të drejtën të ketë një pagesë më të madhe sesa rroga e zakonshme shtesë, sepse është kohë që i duhet për të rikuperuar forcat për të punuar përsëri. Dhe për gjyqtarët bëhet fjalë jo për kohën e punës, bëhet fjalë që ato do jenë të angazhuar ditët e pushimit, do rrinë në gjykata, dhe nuk do pushojnë, por do rrinë në gatishmëri. Nuk do shkojnë të pushojnë, të çlodhen për punën që kanë bërë një javë më parë. Dhe ky është trajtim i barabartë për të tërë gjyqtarët, në dallim nga udhëzimi i kaluar i cili duke pasur gjyqtarë gjykata me 2 veta ose me 1 vetë, i binte që të ishte trajtim i pabarabartë, njëri merrte, tjetri s'merrte. Tani pothuajse gjykatat i ke me një numër relativisht të madh gjyqtarësh dhe ky përfitim pothuajse është i njëjtë.

Fakti që ne mendojmë që ky udhëzim duhet ndryshuar është që kjo është një e drejtë legjitime që buron nga të gjithë aktet, edhe të brendshme edhe ndërkombëtare. Është një e drejtë që i takon kujtdo. Nëse punon ose paraqitet në punë ditën e pushimit, i takon të shpërblehet. Kjo s'besoj se lidhet me nevojën për një analizë financiare. Unë këtë mendim kam.

***Ilir Rusi:*** Po, zoti Toro!

***Alban Toro:*** Atëherë, fatmirësisht i jemi rikthyer një diskutimi të cilin, të paktën personalisht si pakicë e kam mbështetur që në krye të herës, që për shkak të statusit të veçantë që ka gjyqtari, por edhe si çdo qytetar tjetër, ai ka të drejtën të pushojë, por ndërkohë në momentin që ai është i gatshëm, pra duhet të përballojë disa masa sigurimi apo çështje të ngutshme, është i detyruar të prishi axhendën e vet dhe t'i përkushtohet dhe të jetë në dispozicion të gjykatës. Kaq është dhe e mjaftueshme (ky është thelbi i problemit) është e mjaftueshme që atij t'i garantohet një pagesë ekstra për këtë pjesë, për ditën e pushimit të cilën e ka prishur. Madje unë do shtoj edhe më tej që ndoshta njësitë shpenzuese mund të orientohen nga ne që kjo frymë të shpërndahet edhe për administratën, sepse gjyqtari nuk punon vetëm, por ka edhe një bazë sekretarie e cila

aktualisht, të paktën nga kontaktet që kemi pasur në çdo fund viti me gjykatën, nuk marrin pagesë, megjithëse janë në dispozicion të gjyqtarit. Pra ka një diskriminim midis tyre dhe gjyqtarit.

Unë thashë orientim, nuk thashë t'i urdhëroni. Një orientim njësave shpenzuese që të parashikojnë fonde edhe për sekretaret sepse edhe ato kanë të drejtë të marrin diçka, sepse prishin edhe ata ditën e punës.

Nejse, ishim në diskutimin për gjyqtarët. Kështu që në këtë frymë, në frymën që garanton statusi, si dhe faktin që ata janë të detyruar si çdo qytetar të prishin pushimet e tyre dhe t'i përkushtohen gjykatës, normalisht u takon kjo pjesë e shpërblimit. Kurse pjesa e pabarazisë, një pjesë e gjyqtarëve të cilëve paga e tyre konkurrohej me gatishmërinë, aktualisht nuk besoj se ekziston si risk për shkak se gjykatat janë organizuar së fundmi dhe është përcaktuar numri minimal dhe nuk besoj se ka probabilitet financiar që kjo të ekzistojë si konkurrim (paga e tyre me pagën që përfitojnë nga gatishmëria). Kështu që në këtë prizëm unë do të isha pro miratimit të kësaj, natyrisht duke shtuar edhe atë pjesën e orientimit karshi sekretarisë apo administratës, sigurisë, etj., etj., që është në dispozicion të gjyqtarit, dhe pak a shumë kjo është edhe në frymën e institucioneve të tjera publike. Pra nuk mund të mendojmë që në ditë të diel, shërbimet e zjarrfikëses apo të ndërhyrjes së shpejtë, policisë, të mos paguhen, sepse nuk ka pasur rast zjarri apo nuk ka pasur ndërhyrje, ato paguhen. Apo mjeku i urgjencës, megjithëse ai qëndron aty dhe nuk shkon në ndonjë vend, sepse fatmirësisht nuk do ketë nevojë për të, ato paguhen, kjo është e sigurt, sepse e garanton Kodi i Punës. Në të njëjtën frymë do paguhet edhe gjyqtari i cili prish axhendën e vet dhe i dedikohet gjykatës për çdo rast që do dali për të gjykuar në ato ditë pushimi. Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Toro!

Po, zoti Hado!

***Ridvan Hado:*** Edhe unë jam dakord me zonjën Luli dhe zotin Toro për pranimin e kërkesës për ndryshimin e udhëzimit të nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare” për kompensimin e tyre financiar. Mjafton fakti që të jenë në listën e gatishmërisë apo të kryejnë gjykime kur

s'janë në listën e gatishmërisë, të natyrës 24 orë deri në 72 orë. Është një e drejtë që i takon çdo gjyqtari për ditët e pushimit, duke prishur kohën e tij të pushimit dhe duke qenë në gatishmëri për t'i shërbyer sistemit. Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Hado!

Po, zoti Kurushi!

***Klodian Kurushi:*** Vetëm një koment kam në lidhje me këtë.

Unë mendoj që situata e sotme nuk lidhet me faktin nëse duhet të paguhet gjyqtari apo jo ditën që ai nuk gjykon megjithëse është i gatshëm. Pse? Sepse ne kemi mbajtur një standard. E ka mbajtur Këshilli një standard më përpara dhe ka thënë që ai nuk paguhet për shkak të trajtimit të diferencuar që ekziston midis gjyqtarëve të shkallëve të para. Domethënë, referuar kësaj baze të dhënash, ndoshta mund të ketë qenë një analizë financiare që na ka çuar në konkluzionin që ka një trajtim të pabarabartë të gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë në marrjen e kompensimit financiar, për rastet kur ata janë në gatishmëri; gjyqtarëve të gjykatave të rretheve merrnin gjithë kohës megjithëse nuk konsumoheshin (pra nuk shkonin në punë) sepse s'kishte çështje, ndërkohë që gjyqtarët e gjykatave të mëdha ishin gjithë kohës të zënë dhe e merrnin për shkak të numrit të madhe të çështjeve që ata gjykonin në kohën e gatishmërisë. Ky është qëndrimi që kemi mbajtur. E kemi mbajtur këtë qëndrim dhe kemi marrë një vendim më përpara. Sot ka ardhur një relacion i ri dhe relacioni i ri është mbështetur (me ç'kuptoj dhe me ç'shikoj nga materialet që kanë ardhur) vetëm referuar hartës, apo jo. Elementi përbërës që ka ndryshuar qasjen nga Komisioni për ta sjellë, është harta, e pashoqëruar me një tablo financiare. Domethënë, ideja është, jam dakord ta bëjmë këtë pjesë, nuk është se jam kundër, por a duhet të shoqërohet kjo edhe me një panoramë financiare në raport me faktin nëse harta e re gjyqësore i ka sheshuar këto diferenca që ekzistojnë mes gjykatave të mëdha dhe gjykatave të vogla, apo jo? Sepse hera e parë kur është marrë një vendim nga ky Këshill, për bazë ka qenë ky element, komponenti i situatës së diferencuar financiare midis gjykatave të mëdha dhe gjykatave të vogla. Pra ato që ishin gjykata të vogla paguheshin më shumë pa bërë punë dhe ato që ishin gjykata të mëdha paguheshin për sa kohë që bënin punë. Ky ka qenë elementi që ka vendosur standardin e Këshillit të

Lartë Gjyqësor në marrjen e atij vendimi, atij udhëzimi më përpara. Sot, është i mjaftueshëm vetëm elementi i hartës, të na bëjë të ndryshojmë qasje? Mos duhet edhe një analizë shoqëruese financiare? Pra ekziston sot trajtimi i pabarabartë në çështjes mes gjykatave të vogla dhe të mëdha?

*(Disa nga anëtarët ndërhyjnë pa ndezur mikrofonat.)*

**Klodian Kurushi:** Po s'është marrë për bazë elementi... e para nuk është marrë për bazë është marrë trajtimi.

**Fatmira Luli:** Klodi, bëhet fjalë për një të drejtë legjitime. Je në dispozicion të punës ditën e pushimit. S'ke pse përjashtohesh nga shpërblimi. Kjo ka qenë.

**Ilir Rusi:** Atëherë, fjala për zotin Hallunaj!

**Dritan Hallunaj:** Atëherë, faleminderit!

Sot po diskutohet ndryshimi i vendimit nr. 38, datë 28.02.2019. Duke u kthyer në retrospektivë dhe duke analizuar ato që kemi diskutuar atëherë, unë personalisht kujtoj që kam qenë, duke qenë gjithmonë pro idesë që gjyqtari duhet të paguhet kur është në ditët e pushimit apo festave zyrtare, për shkakun se gjyqtari ato ditë privohet nga çdo veprimtari tjetër, familjare, personale, dhe është në shërbim të gjykatës. Edhe në atë diskutimin e atëhershëm, që mban datën 28 shkurt 2019, këtë kam thënë, që jam dakord. Por për shkak se erdhi një informacion nga ish-Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor ku na rezultonte që kishin gjykata me dy gjyqtarë dhe paguheshin, 15 ditë gatishmëri kishte njëri, 15 ditë gatishmëri i bie që të kishte gjyqtari tjetër, dhe pagesa që merrnin këto gjyqtarë ishte një element përcaktues, pra fatura financiare ishte një element përcaktues i pagës së gjyqtarit, duke e krahasuar këto me gjykatat e rretheve të tjera. Ky ka qenë shkakun që unë, në ato kushte që ne ishim, ndryshova qëndrimin tim dhe thashë dakord, në këto kushte unë e ndryshoj qëndrimin tim për efekt të faturës financiare dhe të kemi një balancë mbi të gjithë gjyqtarët, në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Ju e dini që në disa gjykata që kanë më pak dosje apo i bie që të jenë më shumë në gatishmëri, të paguhen më

shumë sesa një gjyqtar në Tiranë apo në një rreth tjetër të madh që ka një ngarkesë së jashtëzakonshme dosjesh dhe që për efekt të gatishmërisë nuk merr pagesën e tillë, pra paguhet shumë më pak në raport me gjyqtarin tjetër. Pra kjo ka qenë që unë e kam ndryshuar dhe kam thënë që ok, dakord, unë bashkohem me pjesën tjetër vetëm për këtë efekt, pra për efekt të përcaktimit të pagës së gjyqtarit që kudo të jetë e barabartë. Pikërisht duke qenë në ato kushte që ne kemi qenë atëherë, pra që kishim gjykata, kishim sistemin në një situatë shumë të vështirë, dhe ne kemi qenë vetë prezent se kemi bërë mbledhje edhe 3 herë në ditë për të komanduar apo deleguar gjyqtarët për të shqyrtuar çështje të veçanta nga një rreth në një rreth tjetër, pra kemi pasur atë situatë. Sot nuk jemi në atë situatë. Duke mos qenë në atë situatë, dhe me implementimin e hartës së re gjyqësore, vlerësohet dhe çmohet nga Komisioni, me të drejtë, kanë paraqitur që nuk ekziston më ai kushti që na mbante varur ne, dhe personalisht për mua nuk ka nevojë që të kemi një faturë financiare si është gatishmëria e gjyqtarit, tani nëpër gjykata ku kemi minimumin e numrit të gjyqtarëve 7, i bie që të kenë gatishmërinë siç do t'i bie rast pas rasti dhe nuk ka nevojë që ne të futemi dhe të bëjmë një hulumtim mbi faturën financiare. Unë e kam shpjeguar këtë (vij gjithmonë në kujtesë), e kam ndryshuar qëndrimin vetëm për këtë arsye, pasi bindja ime e atëhershme por edhe e sotmja është që gjyqtari që është i gatshëm, pra është në gatishmëri, pavarësisht gjykon apo nuk gjykon në ditë të festave, në ditë të pushimeve, duhet paguar. I qëndroj këtij qëndrimi dhe jam plotësisht dakord me atë që ka parashtruar edhe Komisioni por kryesisht doja të sqaroja më tepër pozicionin tim në mënyrën e votimit në atë kohë. Pra ka qenë shkak tjetër. Ishte periudha në të cilën po kalonte sistemi, referuar kjo me pagesën që merrnin një kategori gjyqtarësh, në raport me gjyqtarët e gjykatave të tjera ku numri ishte më i madh dhe nuk kishin një gatishmëri të tillë, pra një numër gjyqtarësh që të kishin gatishmërinë në mënyrë aq të shpeshtë sa mund të kishte në një gjykatë të vogël. Faleminderit!

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zoti Hallunaj!

Po, zonja Ukperaj!

***Brikena Ukperaj:*** Atëherë, në ligjin “për statusin” nuk ka asnjë dispozitë të veçantë që të parashikojë që elementi i pagës së gjyqtarit është edhe shtesa për shkak të

punës së kryer në ditët e pushimit zyrtar ose në festat zyrtare, nuk ka elementë (në qoftë se i referohemi ligjit “për statusin”, dispozitës). Dispozita që ne kemi përdorur në atë kohë ka qenë Kodi i Punës për shkak sepse ligji parashikonte, neni 11, nga se përbëhet paga e magjistratit dhe thotë “...çdo përfitim tjetër duke u bazuar në kushtet e veçanta të punës ose gjendjen familjare dhe personale të magjistratit”, pra përfitim tjetër bazuar në kushtet e veçanta të punës. në kushtet e veçanta të punës i referohemi nenit 91 të Kodit të Punës, që parashikon: Orët shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare, kompensohen me pushim ose pagë të paktën 50% më të madhe se orët shtesë të bëra ose paga normale (kur llogaritet paga normalisht kihet parasysh edhe ditët e pushimit zyrtar që ne kemi), me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratën kolektive. Ky kompensim përfshin edhe kompensimet e përfshira në paragrafët paraardhës (pra janë disa paragrafë që rregullojnë situatat e tjera).

Pra nëse thërresim për zbatim Kodin e Punës, Kodi i Punës kërkon orët shtesë që kryen gjatë pushimit javor ose në festë zyrtare.

Tani, ku do ta dallojmë ne punën e kryer nga gatishmëria për të kryer punë? Ky shpërblim nuk jepet sepse gjyqtarit i priset planifikimi, anulon një udhëtim sepse gjyqtari, jetën e vet personale e ka të lidhur me punën. Shpeshherë thuhet, të qenit gjyqtar është mënyrë jetese. Për këtë arsye edhe kur bëme vendimin (e referova edhe një herë) e çështjes së Gjyrokastres, ne thamë që gjyqtari nuk ka kohë pune. Thamë që gjyqtari nëse një ditë nuk gjykon, atëherë ditën tjetër e planifikon vetë me gjykime. Në qoftë se ka shumë gjykime të shtunën, ditën e hënë nuk lë gjykime. Pra është brenda natyrës së punës së gjyqtarit. Unë mendoj që ka një ndarje midis të qenit i gatshëm dhe të ofruarit punë pra të zhvillimit të seancës kur je i gatshëm. Sepse ne sot e dimë ngarkesën e të gjitha gjykatave. Të gjithë gjyqtarët sot të shtunë të diel ndodhen përpara kompjuterit të arsyetojnë vendime dhe mendoj që puna e këtyre gjyqtarëve, që të gjithë, qoftë pasditeve, qoftë të shtunave, qoftë të dielave, arsyetojnë vendime, është shumë herë më e madhe ofruar sesa një gjyqtari që thjesht është i gatshëm dhe nuk bën asgjë ose pret ta njoftojnë që ka ardhur një masë sigurimi. Flasim, për të bërë një trajtim dinjitoz të figurës së gjyqtarit dhe të punës efektive që gjyqtari bën.

Megjithatë, ky është qëndrimi im lidhur me të drejtën themelore të pagës për sa i përket të paguarit ose të qenët e gjyqtarit në gatishmëri, sepse flasim për punë këtu. Besoj

që të gjithë jemi dakord që të qenët e gjyqtarit në gatishmëri nuk është seancë gjyqësore e zhvilluar. Nëse gjyqtari do shkojë të zhvillojë seancën gjyqësore (bëri një, bëri dy, bëri dhjetë, bëri njëzet) ai do të paguhet njësoj, nuk diskutohet. Nëse nuk shkon të zhvillojë seancë gjyqësore, këtë parashikonte udhëzimi, nuk mund të paguhet.

Tani, për të pasur edhe një ide, si ka ecur funksionimi i hartës së re gjyqësore në gjykatat me 7 gjyqtarë, meqenëse edhe disa anëtarë të Këshillit kanë pasur një qasje tjetër për sa i përket të drejtës për ta përfituar ose jo, por të detyruar nga situata financiare dhe nga trajtimi i pabarabartë që shkaktonte në atë kohë për shkak të numrit të gjyqtarëve, kanë votuar pro. Mund të kem një tabelë për të parë nga 1 maji deri sot që ne jemi, sa është paga që gjyqtarët kanë marrë për secilën gjykatë, për orët jashtë orarit që ata kanë ushtruar dhe sa është numri i masave të sigurimit të shqyrtuara në secilën gjykatë?

***Ilir Rusi:*** Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime të tjera?

Po, zoti Kurushi!

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit!

Po e shtroj në formën e një propozimi sepse unë dakordësohem me këtë pjesën që tha zonja Ukperaj. Nëse kolegët bien dakord që ne të kemi në dispozicion edhe një pasqyrë financiare mbi trajtimin financiar të gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, për të arritur dhe për të marrë një të dhënë tjetër shtesë: trajtimi është i barabartë ose përafërsisht i barabartë, apo tërësisht i diferencuar nga njëri-tjetri. Kjo mendoj se mund të na çojë në një konkluzion më të drejtë në lidhje me projektin sot. Por unë këtë e bëj për propozim tani në seancë. Nëse kolegët dakordësohen me këtë propozim, ta hedhim në votë. Pra është e nevojshme? Unë them që është e nevojshme një pasqyrë financiare. Nëse kolegët thonë nuk është e nevojshme, pastaj vazhdojmë më tej. Faleminderit!

Pra unë e kam si propozim. Për mua duhet edhe një pasqyrë financiare. Faleminderit!

***Brikena Ukperaj:*** Mundem zoti Kryetar?



**Ilir Rusi:** Fjala për ju.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, që mos të kemi edhe diskutime të tjera.

Unë dëgjova opinionet e të gjithë anëtarëve dhe pavarësisht kërkesës që unë bëra, e shikoj që nuk ka efekt, nuk do ketë efekt në vendimmarrje, sepse të gjithë e shprehën opinionin e tyre pro ndryshimit të propozimit. Kështu që, nuk tërhiqem, sepse qëndrimi im lidhur me udhëzimin është në thelb, në thelb të së drejtës. Unë mendoj që qenia në listë gatishmërie nuk është kohë pune dhe për sa kohë nuk është kohë pune, nuk duhet të trajtohet gjyqtari me 50% pagesë nëse nuk bën asnjë seancë gjyqësore, për të trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë gjyqtarët. Në këto kushte, meqenëse kolegët tashmë e kanë shprehur mendimin e tyre dhe analiza financiare, ajo që unë kërkova nuk ka efekt për sa i përket konkluzioneve, mund të vazhdojmë me procedurën e votimit.

**Ilir Rusi:** Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse zonja Ukperaj u tërhoq nga qëndrimi i saj i mëparshëm në lidhje me vijueshmëinë e shqyrtimit të këtij akti, dhe meqenëse nuk ka diskutime të mëtejshme mbi atë çfarë u relatua nga relatori për këtë akt, po kalojmë tek votimi i këtij projektvendimi që është paraqitur.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Kundër, me të gjitha argumentat që dhashë.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare””.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Pika 2 e Udhëzimit nr. 38, datë 28.02.2019 “Për pagesat e gjyqtarëve në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare”, ndryshon në përmbajtje si më poshtë:

“2. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë dhe/ose gjyqtari i gjykatës së apelit kompensohet financiarisht sipas pikës 1, nëse është në listën e gatishmërisë ose gjykon çështje urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 24-72 orëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë.”

Ky ndryshim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 08.11.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës së z. {...} për ushtrimin e së drejtës për t’u caktuar në një gjykatë në nivel apeli”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>3</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:42 dhe mbaroi në orën 15:27.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                                 |
|---------------------------|---------------------------------|
| <b>1. Ilir Rusi</b>       | <b><i>(zëvendëskryetar)</i></b> |
| <b>2. Klodian Kurushi</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>4. Dritan Hallunaj</b> | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>5. Ridvan Hado</b>     | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>6. Alban Toro</b>      | <b><i>(anëtar)</i></b>          |
| <b>7. Brikena Ukperaj</b> | <b><i>(anëtare)</i></b>         |
| <b>8. Yllka Rupa</b>      | <b><i>(anëtare)</i></b>         |

<sup>3</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e gjashta sipas rendit të ditës.

**Shënim 1:** Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Irena Plaku dhe znj. Marçela Shehu*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Valbona Bala, eksperte (EWMI).**
- 6. Sarmela Titka, përfaqësuese Ambasada Amerikane.**
- 7. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës së z. {...} për ushtrimin e së drejtës për t’u caktuar në një gjykatë në nivel apeli”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

**Ilir Rusi:** Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që është pika 6 e saj, ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës së z. {...} për ushtrimin e së drejtës për t’u caktuar në një gjykatë në nivel apeli”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

**Klodian Kurushi:** Faleminderit zoti Rusi!

Në lidhje me relacionin e përgatitur për ta prezantuar ditën e sotme, ju bëj me dije paraprakisht që jam njoftuar nga pjesa administrative, stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor se zoti {...} ka paraqitur një kërkesë për shtyrjen e shqyrtimit të relacionit

të përgatitur mbi bazën e kërkesës së adresuar nga zoti {...} në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Arsyet e shtyrjes të shqyrtimit të këtij relacioni zoti {...} i ka bërë prezent duke dërguar kërkesën në formë elektronike. Besoj se kjo kërkesë është vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve.

Ndodhur në këto kushte kur zoti {...} ka kërkuar që të marrë kohë për t'u njohur me relacionin përkatës si dhe për të bërë ndoshta pas njohjes së relacionit parashtresa ose qëndrime në lidhje me këtë relacion, unë kërkoj që të pranohet kjo kërkesë e z. {...} dhe të shtyhet relacioni për t'u shqyrtuar në një moment të dytë. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, nga relatori zoti Kurushi, për shkak të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi z. {...}, u kërkua për t'u shtyrë dhe dhënë kohë, po vazhdojmë me votimin e propozimit të zotit Kurushi për t'u shtyrë shqyrtimi i saj.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord me kërkesën e paraqitur nga zoti {...}. Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Dakord.

Atëherë shtyhet shqyrtimi i kësaj pike të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës së z. {...} për ushtrimin e së drejtës për t'u caktuar në një gjykatë në nivel apeli”, për shkak të kërkesës së tij dhe të votuar nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor prezent në mbledhje.

**Ilir Rusi:** Në vijim të mbledhjes, meqenëse çështjet janë të karakterit të cilat përmbajnë të dhëna që nuk bëhen publike, do të vazhdojë kjo mbledhje me dyer të mbyllura.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**